

AWEN

Rrjeti i Fuqizimit të
Gruas në Shqipëri



2021 RAPORT VJETOR



Projekti “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri” 2019–2021, mbështetur nga Sida - Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim synon mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të grave në Shqipëri.

Ndikimi i pandemisë në statusin socio-ekonomik të grave

Marsi i vitit 2020 shënoi fillimin e një pandemie globale që ndikoi jashtëzakonisht grupet më vulnerabël, veçanërisht vajzat dhe gratë. Pabarazitë ekzistuese gjinore u amplifikuan dhe gratë u goditën më rëndë nga emergjenca. Bazuar në vëzhgimet tona në terren, ndikimi socio-ekonomik i pandemisë mbi gratë në Shqipëri ka qenë i konsiderueshëm edhe gjatë vitit 2021. Gjithësesi, AWEN dhe organizatat anëtare u përshtatën në mënyrë proaktive me situatën e re duke vazhduar punën për të mbrojtur, promovuar dhe respektuar të drejtat e grave të grave në vend.

AWEN dhe anëtarët zgjeruan modalitetet e tyre të punës. Kjo ka përbërë një sfidë por ndërkohë është gjithashtu arritje, duke marrë parasysh reagimin e menjëhershëm të organizatave dhe përshtatjen e tyre me situatën. Nevoja për t’iu përgjigjur nevojave të grupeve të synuara ka çuar në një bashkëpunim të shtuar me aktorët e nivelit lokal dhe qendror i cili ka vazhduar edhe gjatë këtij viti me synimin e përbashkët për t’u përshtatur më mirë me nevojat sipas situatës dhe për të vazhduar ofrimin e shërbimeve themelore.





Mbështetja financiare gjatë 2021 u fokusua në disa komponentë dhe ka shënuar arritjet e mëposhtme:

Ofrim i shërbimeve mbështetëse të specializuara për përfitueset, siç janë shërbimet e referimit, shërbimet psiko-sociale dhe ligjore, shërbime strehimi (emergjence ose afatgjatë), ndërhyrje ri-integruese (arsimim, formim profesional, ndërmjetësim për punësim etj.) si dhe ngritje kapacitesh të aktorëve vendorë:

- ♦ 981 aktorë lokal janë përfshirë në aktivitete nga AWEN dhe organizatat anëtare;
- ♦ 3469 gra dhe vajza, viktimat të dhunës në familje kanë përfituar mbështetje dhe asistencë direkte. 331 fëmijë të tyre janë mbështetur gjithashtu me shërbime;
- ♦ 102 viktimat trafikimi / të mundshme trafikimi dhe 66 fëmijë të viktimave janë mbështetur me shërbime nga Qendra "Vatra";
- ♦ 191 gra/vajza dhe fëmijë janë mbështetur me strehim emergjent dhe strehim afatgjatë;
- ♦ 3469 thirrje telefonike janë marrë nga Linja Kombëtare e Këshillimit dhe 827 raste janë asistuar direkt nga këshilluesit e LKK.
- ♦ 1400 raste të viktimave të dhunës në familje janë menaxhuar nga anëtarët e tjera të AWEN (krahas 3469 rasteve të mbështetura nga LKGV);
- ♦ 123 gra janë mbështetur me formim profesional, janë punësuar ose vetëpunësuar;
- ♦ 7040 gra, vajza, burra dhe djem janë sensibilizuar nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit;
- ♦ Rreth 100000 persona kanë marrë mesazhe sensibilizuese nëpërmjet medias sociale, fushatave ndërgjegjëse, etj.;
- ♦ 102 burra dhe djem dhunues kanë përfituar nga shërbimet rehabilituese të ofruara nga Zyra për Djem dhe Burra në Shkodër;
- ♦ 35 Mekanizma të referimit pranë Bashkive janë mbështetur për menaxhim rasti.

PROJEKTET/GRANTET E VOGLA TË ADVOKACISË – fokusi, organizatat përfituese, ecuria;

Në muajin Mars 2021, AWEN nisi bashkëpunim me 13 organizata të shoqërisë civile, në kuadër të Thirrjes së Tretë për Propozime mbi “Çështje për advokim lidhur me mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të grave në Shqipëri”, lançuar nga AWEN gjatë muajit Shkurt 2021. Për këtë thirrje do patën prioritet ndërhyrjet advokuese dhe monitoruese që adresonin pjesëmarrjen e grave në politikëbërje e vendimmarrje.

Projektet janë vlerësuar bazuar në: qasjen teknike (rëndësia e nevojave dhe çështjeve të adresuara, arsyetimi i nevojës së menjëhershme për ndërhyrje, cilësia e aktiviteteve të propozuara, logjika e ndërhyrjes së orientuar drejt rezultateve), kapacitetet organizative/të grupimit (kapacitetet organizative dhe administrative, përvoja relevante në tema të ngjashme), buxheti i propozuar (kosto dhe shpenzime të përshtatshme për ndërhyrjen). Projektet fituese kanë variuar nga 2875 Eur deri në 4000 Eur dhe tematikat kyçe që janë adresuar, kanë qenë si më poshtë:



PROJEKTET/GRANTET E VOGLA TË ADVOKACISË – fokusi, organizatat përfituese, ecuria;

Organizata implementuese



Qendra për Advokim Social

Fuqizimi i grave dhe vajzave rome dhe egjiptiane në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e tyre në procesin e votimit dhe monitorimit.

Zona e implementimit: Tiranë dhe Fier.
Shuma: 4000 Eur



Qendra "Tirana Art"

Krijimi i një mjedisi që garanton barazi legjitime dhe demokratike në përfshirjen e grave dhe vajzave në procesin e vendimmarrjes.

Zona e implementimit: kombëtare.
Shuma: 3,965 Eur



Qendra "Gratë në Shërbim Publik"

Advokatësi dhe ndërgjegjësim në komunitetin e Tropojës mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në votim dhe shmangia e manipulimit të votës.

Zona e implementimit: Tropojë.
Shuma: 3,000 Eur



Past4Future

Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje dhe qytetaria aktive.

Zona e implementimit: Korçë.
Shuma: 3,000 Eur



Aleanca Pro-LGBT në Shqipëri

Promovimi i raportimit etik në media duke shmangur gjuhën diskriminuese, gjuhën e urrejtjes dhe seksiste.

Zona e implementimit: Korçë dhe mbulim kombëtar.
Shuma: 3,000 Eur



Mjedisi për Komunitetin në Shqipëri

Rrjetëzim në nivel rajonal me gra dhe vajza të komunitetit Rom dhe Egjiptian në rajonin e Beratit me qëllim fuqizimin e tyre për të ushtruar të drejtën e votës dhe për t'u zgjedhur.

Zona e implementimit: Berat.
Shuma: 3,000 Eur



AMAD

Advokatësi për të drejtat e grave, për të drejta të barabarta në politikë dhe vendimmarrje nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të grave.

Zona e implementimit: Dibër dhe Fier.
Shuma: 2875 Eur



"Hapat e lehtë"

Promovimi i një prespektive rajonale elektorale në zonat lokale dhe rurale për përfshirjen e grave në votim si një e drejtë themelore dhe promovimi i nevojës për programe elektorale gender-sensitive.

Zona e implementimit: Bashkitë Pukë, Malësi e Madhe, Vau Dejes, Shkodër dhe Fushë-Arrëz.
Shuma: 3,000 Eur

PROJEKTET/GRANTET E VOGLA TË ADVOKACISË – fokusi, organizatat përfituese, ecuria;

Organizata implementuese



Për ju nëna dhe fëmijë

Nxitja e pjesëmarrjes në votim të grave dhe vajzave duke u fokusuar tek vajzat që votojnë për herë të parë.

Zona e implementimit: Bashkia Kukës.

Shuma: 3,000 Eur



Rromano Kham

Të informohet dhe përgatitet komuniteti Rom në Lushnje dhe Vlorë për të artikuluar problemet e tyre në mënyrë konstruktive në mënyrë që të ndërtohet komunikim “politik” me kandidatët në zonat respektive.

Zona e implementimit: Lushnje (Saver) dhe Vlorë (Novoselë)

Shuma: 3,249 Eur



New Bridges

Të përmirësohet situata e grave në qarkun e Beratit lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje dhe jetën shoqërore. Të rritet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në jetën politike.

Zona e implementimit: Bashkitë Berat, Kuçovë, Ura Vajguore, Poliçan dhe Skrapar.

Shuma: 3,000 Eur



EJF Production

Të krijohet një video virale për të rritur pjesëmarrjen e grave në votimet e Prillit 2021.

Zona e implementimit: kombëtare.

Shuma: 3,000 Eur



For the Benefit of Women, Communities, People in Need and Persons with Disabilities

Respektimi i të drejtave të grave dhe arritja e barazisë gjinore në vendimarrje.

Zona e implementimit: Bashkia Elbasan (Labinot Fushe and Gjinar).

Shuma: 3,000 Eur



AWEN/Sida – GRANTET PËR TËRMETIN – tre projekte me një buxhet total prej 60.000 Eur



Shoqata "Gender, Paqe e Siguri", Durrës ka zbatuar me sukses projektin "Qendra për Mbrojtjen e qytetarëve të dëmtuar nga tërmeti-Durrës", në periudhën kohore 16.05.2020 – 15.08.2021, me qëllim ofrimin e ndihmës për qytetarët e dëmtuar nga tërmeti përmes informacionit juridik si dhe shërbimeve juridike e psikologjike, duke patur si synim sigurinë dhe mirëqënien e tyre e që çdo qytetar të marrë atë që i takon me drejtësi të plotë e duke garantuar që zëri tyre të dëgjohet në qarkun Durrës. Është monitoruar procesi i kompensimit dhe rindërtimit me synimin e dhënies së informacionit të saktë në lidhje me të gjitha fazat e procesit dhe ka patur advokim dhe lobim të vazhdueshëm me vendimmarrësit e Bashkisë Durrës. Po ashtu, rreth 705 persona kanë përfituar shërbime ligjore dhe 437 persona kanë përfituar nga shërbimi i mbështetjes psikologjike gjatë periudhës së implementimit të projektit. (40.000 EUR)

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim ka zbatuar projektin " Forcimi i kapaciteteve të qeverive vendore dhe monitorimi i veprimeve të tyre dhe ndihmës ndërkombëtare për rimëkëmbjen e familjeve pas tërmetit", në periudhën kohore 01.05.2020 – 30.04.2021. Projekti ka finalizuar me sukses punën në terren dhe gjetjet në lidhje me përdorimin e fondeve të rikonstruktimit, ka ngritur kapacitetet e njësive administrative Sukth dhe Katund i Ri mbi një sistem të konsoliduar të identifikimit dhe ndjekjes së ndryshimeve të statusit të familjeve të prekura nga tërmeti, ka krijuar një bazë të dhënash për gjurmimin e grave në nevojë. (15.000 EUR)

Linja e Këshillimit për Gra e Vajza, Tiranë ka zbatuar projektin "Rimëkëmbja psikologjike e grave e burrave nga trauma e tërmetit ", në periudhën kohore 01.05.2020 – 28.02.2021, me qëllim trajtimin e traumës pas tërmetit për të arritur shërimin psikologjik dhe emocional të burrave dhe grave, të mbijetuar nga tërmeti i vitit 2019 në Shqipëri. Pas finalizimit të punës përgatitore dhe vlerësimit është shpërndarë një manual vetë-ndihmues personave të targetuar. 468 sesione këshilluese ballë për ballë dhe 163 sesione përmes telefonit janë realizuar me 43 përfitues. (10.000 EUR).

STUDIMI KOMBËTAR PËR DHUNËN SEKSUALE: DHUNA NË MARRDHËNIET INTIME DHE DHUNA SEKSUALE TEK TË RINJTË NË SHQIPËRI

AWEN ka realizuar një studim kombëtar lidhur me dhunën seksuale mes të rinjve, duke hulumtuar rreth incidencës, formave dhe pasojave të saj. Studimi ka targetuar të rinjtë e moshës 20 – 24 vjeç. Në skuadrën e përzgjedhur të studiueseve kanë bërë pjesë pedagogët dhe studiueset Elona Dhëmbo dhe Veronica Duçi. Pas pilotimit të pyetësorit të përpiluar, nisi faza e anketimit në terren në 12 qarqet e Shqipërisë, në bashkëpunim me organizatat anëtare të AWEN. Studimi është finalizuar në muajin Prill 2021 dhe është lançuar në muajin Maj në një takim online me anëtarët e AWEN, bordit, partnerët, përfaqësues nga SIDA dhe me pjesëmarrjen e Ambasadores Suedeze në Shqipëri Zj. Elsa Hastad. Gjatë takimit janë prezantuar gjetjet kryesore të studimit, gjetje të cilat vazhdojnë të shpërndahen për publikun e gjerë nëpërmjet infographics nga AWEN dhe organizatat anëtare në rrjete sociale dhe kanale të tjera komunikimi.



“Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri”



Një përqindje shumë e lartë

e përgjigjedhënësve mendojnë se dhuna seksuale ndaj grave në Shqipëri është e përhapur (80%), qoftë kjo nga partnerët ose nga njerëz në rrethin e besimit apo të panjohur.

Thuajse gjysma

e kampionit ka dëgjuar për raste të dhunës ndaj grave në qytetin ose fshatin e tyre, ndërsa 1 në 5 prej tyre në lagjen e tyre.



Qëndrimet stereotipizuese

ndaj disa sjelljeve “provokuese/ambige” të vajzave janë ende të pranishme mes djemve dhe vajzave, si p.sh. 23% prej tyre e justifikojnë dhunën seksuale kundër dëshirës së personit kur është paraprirë nga flirtimi, 22% kur ka veshur një sjellje provokuese dhe 16% kur personi ecën vetëm natën.

PËRPPJEKJET ADVOKUESE GJATË 2021



- ☐ Nisma dhe finalizimi i Protokollit për Strehëzat gjatë pandemisë;
- ☐ Dhënia e inputeve për Progres Raportin e Komisionit European mbi Shqipërinë;
- ☐ Dhënia e sugjerimeve gjatë procesit të konsultimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të Veprimit 2021-2030;
- ☐ Dhënia e sugjerimeve gjatë procesit të konsultimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të Veprimit 2021-2030;
- ☐ Dhënia e rekomandimeve mbi VKM 327, datë 02/06/2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”;
- ☐ Reagim lidhur me propozimin për “Hartën e re gjyqësore” nga Këshilli i Lartë Gjyqësor drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë sa i takon cënueshmërisë dhe nevojave të gjithë qytetarëve por kryesisht vajzave dhe grave ;
- ☐ Bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit European në Shqipëri në procesin e konsultimit me shoqërinë civile lidhur me Gender Action Plan III të Bashkimit European për Shqipërinë. Përgatitja e pyetësorit drejtuar OSHC-ve si edhe e një raporti të përmbledhur duke përfshirë gjetje dhe rekomandime të dala nga pyetësori; Raporti u prezantua gjatë një takimi të përbashkët online;
- ☐ Nisma advokuese lidhur me miratimin e ligjit për krijimin e regjistrit të autorëve të dhunës seksuale, nismëtare “Linja e Këshillimit për Gra e Vajza”, “Aleanca Gjinore për Zhvillim” dhe AWEN; (proces ku janë angazhuar edhe organizatat e tjera të rrjetit). AWEN dhe organizatat kanë qenë pjesë e takimeve konsultuese të përbashkëta me Kuvendin e Shqipërisë si edhe komisionet e posacme lidhur me draftimin e ligjit
- ☐ Thirrje për shmangien e trajtimit riviktimizues ndaj viktimave të dhunës në familje dhe për dhënien e mesazheve të drejta kundër dhunës me bazë gjinore, drejtuar televizionit “Top Channel”, Autoritetit të Medias Audiovizive, etj. Iniciativë e ndërmarrë nisur nga trajtimi i një prej historive personale të shfaqura në programin “Dua të bëj të lumtur”, Janar 2021;

PËRPJEKJET ADVOKUESE GJATË 2021

Thirrje për shmangien e viktimizimit të pjesëmarrësve në programin “Përputhen” dhe transmetimin e mesazheve të drejta kundër dhunës me bazë gjinore drejtuar televizionit “Top Channel”, “”, Autoritetit të Medias Audiovizive, etj., Nëntor 2021;

Deklaratë Publike ku i rekomandohet Kuvendit të dërgojë për Opinion Ligjor në Komisionin e Venecias projektligjin “Për Regjistrimin e OJF-ve” dhe të shmangë miratimin e tij në kushtet e urgjencës;

Raportim për Komitetin e Palëve të Këshillit të Europës për Konventën e Stambollit rreth raportit të dërguar nga autoritetet shqiptare mbi implementimin e rekomandimeve të GREVIO për Shqipërinë;

Problematika, gjetje dhe rekomandime lidhur me punën e Policisë së Shtetit në mbrojtje të viktimave të dhunës, dërguar Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Dhjetor 2021.

Monitorim i trajtimit të një rasti femicidi drejtuar institucioneve përgjegjëse lidhur me zbatueshmërinë e ligjit dhe ndëshkueshmërinë: Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Institutit të Mjekësisë ligjore, Komisionit parlamentar për punën, çështjet sociale dhe shëndetësinë, Nënkomisionit parlamentar për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas, etj.



PËRPJEKJET ADVOKUESE GJATË 2021



Nisma advokuese lidhur me dhunën seksuale, nismëtare së bashku me organizatën anëtare 'Linja e Këshillimit për Gra e Vajza' dhe gjithë organizatat e rrjetit. Eshte advokuar dhe lobuar lidhur me:

- Krijimi i regjistrit të autorëve të krimeve seksuale, të ruhen të dhënat për 30 vjet – miratuar në Kuvend (125 vota pro; 0 kundër; 1 abstenim) AWEN dhe organizatat kanë qenë pjesë e takimeve konsultuese të përbashkëta me Kuvendin e Shqipërisë si edhe komisionet e posacme lidhur me draftimin e ligjit
- Ndryshimet e Kodit Penal për marrëdhëniet seksuale
- Ndryshimi i përkufizimit për përdhunimin, për fëmijët e mitur nga 14 – 18 vjeç.
- Të kriminalizohet sjellja e autorit.
- Vlerësimi i rrishtit për dënimin seksual
- Realizimi i mbikqyrjes së autorëve në komunitet
- Dërgimi i autorëve të krimit në rehabilitim
- Kastrimi i autorëve të krimit për parandalimin e pedofilisë (kastrimi i cili bëhet nëpërmjet marrjes së pilulave apo injeksionit, nuk është i pakthyeshëm, ai vlen për 3 – 4 vite);

AWEN i është bashkuar edhe nismave të rrjeteve apo OSHC-ve të tjera në vend, në reagime apo deklarata publike, ndër të cilat mund të përmendim:

Thirrjen publike që të ndalohet urgjentisht gjuha e urrejtjes, ajo seksiste dhe misogjene ndaj grave kandidate në zgjedhje, me nismën e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore;

Deklaratë e hapur për publikun ku shoqëria civile reagon mbi 10 ligjet e reformës në drejtësi të cilat u miratuan pa konsultim dhe transparencë (Mars 2021), me nismën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit;

Deklaratë "Të merren masat e nevojshme legjislative për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Konventa e Stambollit", me nismën e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore.



PROJEKTE DHE MBËSHTETJE TË TJERA TË RËNDËSISHME GJATË VITIT 2021

Projekti: "Advokim për barazinë gjinore dhe proceset e integrimit në BE", mbështetur nga Kvinna till Kvinna

- **8 aktivitete ndërgjegjëse dhe seanca informuese** u organizuan në Tiranë, Sarandë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Peshkopi dhe Durrës në bashkpunim me organizatat anëtare të AWEN ku morën pjesë më shumë se 65 përfaqësues të MKR-ve në nivel vendor;
- **1 workshop** rreth situatës së trafikimit në vend u zhvillua në bashkëpunim me Aleancën e Grave Këshilltare të Vlorës;
- **Organizata Gruaja tek Gruaja** organizoi 1 FlashMob dhe 1 performancë Gender Transformative Work në bashkëpunim me grupe të të rinjve me 40 djem dhe vajza në Shkodër rreth barazisë gjinore, parë nga perspektiva e BE-së.
- **Unë Gruaja Pogradec** organizoi hapjen e fushates së 16 ditëve me 35 të rinj e të reja, vullnetarë të shkollave të mesme.
- **45 vajza dhe djem**, të shkollave të mesme morën pjesë në aktivitetin ndërgjegjëses dhe informues organizuar nga Forumi Gruas Elbasan në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan dhe Drejtorinë Rajonale të Arsimit.
- **AWEN** ka marrë pjesë aktivisht e ka dhënë kontribut në shumë konsultime, takime advokuese e lobuese të zhvilluara në kuadër të proceseve të integrimit në BE në perspektivën e barazisë gjinore.

“Institucionalizimi i Shërbimeve Cilësore Rehabilituese dhe Ri-integruese për të mbijetuarat e Dhunës” mbështetur nga ADA rajonal Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, North Macedonia, Montenegro, Serbia

Autonomous Women’s Centre (AWC) Serbi është organizata që udhëheq bashkë me 6 organizata të tjera partnere nga rajoni. Për Shqipërinë organizata partnere janë AWEN dhe GADC.

Aktivitetet kryesore janë:

- ✓ Ofrimi i shërbimeve direkte psikologjike dhe ligjore (ofruar nga profesionistë të organizatave të rrjetit). 136 vajza, gra dhe fëmijë kanë marrë këto shërbime gjatë 2021.
- ✓ Rishikimi i legjislacionit dytësor sa i takon çështjeve të barazisë gjinore, përfshirë procedura, politika dhe protokolle të cilat kanë nevojë të krijohen ose përditësohen.

“Mbështetja e bashkive në analizimin dhe adaptimin e modeleve/skemave të reja për integrimin socio-ekonomik për viktimat e DHBGJ-DHF”, mbështetur nga UN Women

- ♦ Gjatë zbatimit të projektit për 2021 AWEN ka mbështetur bashkitë Durrës, Pogradec dhe Shkodër për të azhornuar Planet e Integritit Socio-Ekonomik për gratë viktimat të dhunës në familje dhe të gjithë format e tjera të dhunës.
- ♦ Përmes projektit u mbështetën respektivisht në Bashkinë Durrës me paketa ushqimore, qira dhe produkte higjienike 12 gra të dhunuara. Për Bashkinë Pogradec janë mbështetur me paketa ushqimore 17 raste, gra të dhunuara. Si dhe për Bashkinë Shkodër u mbështetën 10 raste, viktimat të dhunës me paketa ushqimore dhe qira. Në total numri i përfitueseve ishte 39.

- ♦ Gjatë projektit janë zhvilluar 12 workshope në tri bashkitë që projekti u implementua, 6 seanca mentorimi dhe 3 trajnime me autoritetet lokale dhe organizatat e shoqërisë civile me fokus implementin e Planeve Socio-Ekonomike. Numri i përfituesve nga aktivitetet e realizuara përgjatë periudhës së zbatimit Gusht 2021–Dhjetor 2022 ishte 432 aktorë lokalë.
- ♦ Në mënyrë të veçantë AWEN u kujdes që planet të tejkalojnë nevojat emergjente për gratë dhe të jenë në terma afatgjatë (këshillim psiko-social, aktivitete sociale, monitorim, këshillim dhe mbështetje për punësim, ndihmë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të dhunës.
- ♦ AWEN punoi ngushtësisht me organizatat e rrjetit: Shoqata Gender, Paqe, Siguri, Durrës Gruaja tek Gruaja, Shkodër dhe Unë Gruaja, Pogradec për zbatimin e këtij projekti.



Qershor 2021 – Maj 2021 u zbatua projekti: "Forcimi i përgjigjes së koordinuar të ofruesve të shërbimeve nga policia, shëndetësia, arsimi dhe sektorët e qeverisjes vendore për të menaxhuar rastet që lidhen me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me standardet e CEDAW dhe Konventës së Stambollit"
- mbështetur nga UN Women Shqipëri

- ✓ Projekti synoi përmirësimin e performancës të ofruesve të shërbimeve mbështetëse të përgjithshme por dhe të specializuara për viktimat e të gjithë formave të dhunës në 6 bashkitë e targetuara (Fier, Vlorë, Sarandë, Dibër, Korçë, Pogradec)
- ✓ U zhvilluan 24 workshope me aktorët lokalë në çdo bashki me qëllim përgatitjen e planeve të veprimit në përmirësimin e përgjigjes së përgjithshme ndaj DHBGj përmes veprimeve të avokimit që synojnë krijimin e shërbimeve të specializuara të mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore.
- ✓ Rreth 210 gra dhe vajza nga grupet e disavantazuara morën kujdes të menjëhershëm nga shërbimet e mbështetura nga ky projekt (referimi, shërbime psiko-sociale, ligjore).
- ✓ Rishikimi i legjislacionit dytësor sa i takon çështjeve të barazisë gjinore, përfshirë procedura, politika dhe protokolle të cilat kanë nevojë të krijohen ose përditësohen.



Mars 2020 – Jan 2024 "Përparimi i barazisë gjinore përmes procesit të integrimit në BE" mbështetur nga BE dhe zbatuar nga REACTOR, Maqedoni e Veriut me organizata partnere nga Shqipëria, Bosnje dhe Herzegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia



- Rrjetëzim dhe shkëmbim eksperiencash mes **6 organizatave të rajonit**, pjesë e projektit.
- Ngritje kapacitetesh për organizatat lokale me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin e tyre rreth procesit të integrimit në BE.
- **Sub-grante për organizatat lokale** të vendeve partnere, kryesisht rreth monitorimit të reformave të cilat kanë lidhje me gender – 6 të tilla të aprovuara gjatë zbatimit në Shqipëri për 2021.
- **1 Analizë gjinore** e prodhuar në sektor të paanalizuar më parë – Gratë në sektorin e trajnimeve profesionale duke e lidhur me procesin e integrimit në BE për 2021.
- Bashkëpunim me më shumë se **15 organizata lokale** për të monitoruar zbatimin e angazhimeve rreth barazisë gjinore në nivel lokal.
- Advokatësi në nivel lokal dhe rajonal për të përmirësuar **perspektivën gjinore** gjatë procesit të integrimit në BE.

**Korrik 2021 – Qershor 2022 "Gender Equality is a right!"
Forcimi i aktivizmit për të drejtat e grave në Kavajë,
Lushnje dhe Tropojë mbështetur nga Programi i Granteve
te Vogla, USA**



- Ngritje kapacitetesh për **3 grupet informale** dhe organizatat e grave që punojnë në këto bashki nëpërmjet: vlerësimit të nevojave, trajnime, workshope, takime, etj.
- **6 trajnime një ditore** rreth çështjeve kryesore të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave u zhvilluan në tre zonat e synuara: **Tropojë, Kavajë and Lushnje**;
- **45 aktorë lokalë** kanë marrë pjesë në setin e trajnimeve në zonat e targetuara;
- Mbështetje ligjore falas për gratë, vajzat dhe komunitetin - Gjatë zbatimit të projektit janë mbështetur **88 persona në total: 34 vajza dhe gra, 51 fëmijë dhe 3 burra** në Lushnje, Kavajë dhe Tropojë.
- Janë referuar për shërbime ri-integruese afatgjata pranë anëtareve të AWEN, **3 gra nga qyteti i Lushnjes dhe 1 grua nga Tropoja**.
- Eshtë ndërmjetësuar dhe mundësuar punësimi për **3 gra, Lushnje**.



AWEN falenderon të gjithë bashkëpunëtorët për kontributin e tyre në mbështetje të grave e vajzave në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2021,

si dhe shpreh mirënjohjen e thellë për punën e përkushtuar të anëtareve të rrjetit dhe të bordit, Qeverinë Suedeze – Sida, Fondacioni Kvinna till Kvinna, Ambasada e SHBA-ve - Programi i Granteve të Vogla, BE, Un Women Shqipëri, që vazhdojnë të besojnë tek ne duke na mbështetur në vazhdimësi përgjatë 2019-2021!

Faleminderit!

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për: Organizatën jo-fitimprurëse "RRJETI I FUQIZIMIT TË GRUAS NË SHQIPËRI"

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të organizatës jo-fitimprurëse "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e aktiviteteve, dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të organizatës jo-fitimprurëse "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" më datën 31 Dhjetor 2021, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për OJF-të.

Bazat e dhënies së Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për OJF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesve

Objektivi i auditimit tonë është dhënia e një sigurie të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale duke përfshirë këtu mashtrimet apo gabimet dhe për të hartuar një Raport Auditimi i cili përfshin edhe opinionin tonë. Dhënia e një sigurie të arsyeshme është një nivel i lartë sigurie por ajo nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një anomali materiale nëse ajo ekziston.

Anomalitë rrjedhin si rrjedhojë e gabimeve apo mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht apo së bashku mund të influencojnë vendimmarrjen ekonomike të përdoruesve të këtyre Pasqyrave Financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Organizata të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me Drejtimin e Organizatës përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë

Datë 20 Qershor 2022

